

Editorial/

Muaji Rabiul Evvel dhe jeta profetike

Nga Mustafa Tërniqi



Muaji Rabiul Evvel në të cilin gjendemi është muaji i tretë i kalendarit hënor, ose siç njihet ndryshe kalendarit lunar. Sapo futet ky muaj shumica e muslimanëve kujtojnë ditëlindjen e Profetit Muhamed (alejhissalatu uesselam). Shumë të tjerë përgatiten për të festuar datën e lindjes së tij me atë që njihet si “Kremtimi i mevludit”. Cdo musliman gëzohet për lindjen e Profetit Muhamed (alejhissalatu uesselam) mirëpo muaji Rabiul Evvel nuk na kujton vetëm lindjen e tij por dhe jetën e tij profetike të mbushur me ngjarje e ndodhi nga të cilat mësojmë, përfitojmë dhe marrim shembullin dhe modelin e përsosur që fatkeqësisht u mungon sot shumicës së muslimanëve.

Profeti ynë i dashur lindi, jetoj dhe vdiq për të përmbushur mesazhin hyjnor me të cilin ishte ngarkuar. Është pikërisht muaji Rabiul Evvel ai që duhet të na kujtojë më së miri këtë mesazh, pasi në të kanë ndodhur ngjarjet më të rëndësishme të jetës profetike. Në këtë muaj lindi, përfundoi hixhretin dhe vdiq krijesa më e dashur e Zotit Fuqplotë. Nuk është aspak e rastësishme që Zoti i Gjithëdijshëm bëri që Profeti Muhamed të lindë e të vdesë në të njëjtën datë dhe në të njëjtën ditë. Dita e hënë më 12 Rabiul Evvel. Po ashtu nuk është e rastësishme që po në këtë datë ai të mbërrijë në Medine duke përfunduar hixhretin. Sapo mbërriti në Medine ai ndërtoi faltoren ku muslimanët do t'i luteshin Allahut të lirë. Faltorja ishte dhe institucioni

i parë multifunksional që do t'u shërbente muslimanëve në jetën e tyre fetare, politike dhe ekonomike. Menjëherë pas ngritjes së faltores Profeti vëllazëroi mes sahabëve, muhaxhirët me ensarët për të forcuar më shumë bashkësinë islame, kjo ishte dhe themelimi i shtetit të parë islam me qendër Medinen e bekuar. Ky ishte mesazh i qartë që feja islame nuk është thjesht praktikim i disa adhurimeve islame brenda xhamisë ose brenda shtëpisë, por është një sistem i vërtetë jete nga ku lindën shumë perandori apo dinasti përgjatë shekujve.

Po të studiojmë më shumë dhe t'i kthehemi më mirë historisë islame, muaji Rabiul Evvel na bën më të vetëdijshëm që të ndërjegjësohemi më shumë rreth përgjegjësive që na takojnë për ta rikthyer islamin nga një fe xhenazesh, mevludesh, festimesh apo këndimesh për të vdekurit, në një fe madhështore siç është në të vërtetë dhe si alternative e vetme për shpëtimin e njerëzimit nga kriza morale dhe ideologjike që e ka kapluar. Kjo nuk arrihet duke u kujtuar një here në vit me kremtimet e mevludeve, apo festimeve dhe shpenzimeve pa kriter në ato gjëra që në të vërtetë nuk kanë lidhje me islamin. Nëse Profeti Muhamed (alejhissalatu uesselam) lindi dhe vdiq në të njëjtën ditë, në të njëjtën datë dhe në të njëjtin muaj atëherë duhet të hidhërohemi po aq sa dhe gëzohemi. Ashtu sikur nuk është e hijshme që datën e vdekjes së Profetit tonë të dashur ta kthejmë në

ditë pikëllimi dhe vaji ku të vajtojmë me britma e ulërime, po ashtu nuk është e hijshme që të njëjtën datë ta kthejmë në kremtime dhe festime, me lavde e poezi kur e dimë farë mirë se të parët tanë në tre shekujt fatlumë, sahabët, tabiinët dhe tabitabiiinët, përfshi dhe katër imamët e njohur të shkollave juridike islame nuk kanë praktikuar as njërin dhe as tjetrën. Ata nuk festuan dhe as vajtuan në këto forma sepse e kishin kuptuar fare mirë urtësinë e Zotit të Gjithëdijshëm i Cili nëpërmjet këtyre datave të njëjta na tregon se ashtu si Profeti Muhamed (alejhissalatu uesselam) i cili lindi, jetoj dhe vdiq për të përmbushur misionin hyjnor, atëherë dhe muslimanët pas tij duhet të ndjekin të njëjtën rrugë dhe metodë. Këtë e shohim të qartë në tre gjeneratat e para islame, në tre shekujt fatlumë të cilët jetuan dhe vdiqën për të njëjtin mision. Ky mesazh i qartë

na bën të kuptojmë pse gjeneratat e mëvonshme islame ndryshojnë nga gjeneratat e para, në jetën e tyre dhe në praktikimin dhe zbatimin e jetës profetike me përpikmëri dhe në të njëjtën kohë kuptojmë se ky ishte sekret i suksesit të tyre.

Në një këndvështrim tjetër shohim se Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që ta duam shumë Profetin tonë, mirëpo dashuria jonë për të nuk manifestohet duke festuar dhe kremtuar ditëlindjen e tij dhe duke thurur vargje dhe lavde por duke e marrë atë si model praktik në jetën e përditshme. Dashuria për Profetin manifestohet në dy aspekte kryesore; ndjekja e rrugës së tij dhe ringjallja e traditës profetike. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

“Thuj (O Muhamed), nëse vërtet e doni Allahun më ndqini mua dhe Ai do t’ju dojë e do t’jua falë gjynahet. Allahu është falës i

(Vijon në faqen 3...)

Fq. 2/ Pyetje - përgjigje

.....Përgatiti: Lidhja e Hoqxhallarëve të Shqipërisë

Fq. 3/ Islami feja me më shumë ndjekës në botë

.....Përgatiti: Redaksia

Fq. 4/ Halifi Umer, Komandanti Islam Amr ibn Asi dhe Biblioteka e Aleksandrisë

Marrë nga revista Kultura Islame Nr 8

Fq. 6/ Historia e identitetit të Bosnjës

.....Nga Nadim Zaazaa

PYETJE - PËRGGJIGJE

Gjykimi mbi një produkt bankar si alternativë e depozitave me afat.

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi Profetin e fundit, Muhamedin a.s., mbi familjen dhe gjithë shokët e tij.

Asambleja e Jurispodencës Islame pranë Ligës së Botës Islame, në sesionin e saj të 19-të, të mbajtur në Mekë në periudhën 22-27 Sheval 1428 H që i korespondon datës 3-8 Nëntor 2013, shqyrtoi temën: "Një produkt alternativ i depozitave me afat", të cilin e praktikojnë një numër bankash në kohën e sotme nën emra të shumë si p.sh: Murabeha riverse (e kundërt), likuiditet i kundërt, investimi i drejtëpërdrejtë, investim murabeha etj., si dhe nën shumë emra të tjerë bashkohorë që mund të krijohen.

Forma e përhapur këtij produkti bankar funksionon në këtë mënyrë:

1- Klienti i bankës ngarkon (me prokurim) bankën që të blejë një mall të caktuar dhe i dorëzon kësaj të fundit pagësen e mallit menjëherë.

2- Më pas banka ia blen mallin klientit të saj me një pagesë me këste dhe me një fitim të deklaruar dhe të pranuar nga të dyja palët.

Pasi dëgjoi studimet e paraqitura dhe diskutimet e shumta rreth kësaj teme, Asambleja vendosi për moslejimin e këtij shërbimi bankar, për këto arsye:

Ky veprim bankar i përngjan çështjes se Aines (shitblerje që kamuflojnë kamatën) e cila ndalohej fetarisht për faktin se malli i shitur nuk është objekti kryesor në këtë transaksion, si rrjedhojë fiton të njëjtën dizpozitë si ajo e shitblerjes përmes Aines, sidomos për faktin se banka e detyron klientin që ajo ta blejë prej tij këtë mall.

Ky veprim bankar përfshihet në domethënien e "likuiditetit të parashikuar", të cilin Asambleja ka marrë vendim më parë për ndalimin e tij, në vendimin dytë të marrë në sesionin 17-të dhe argumentat me të cilat është justifikuar ndalimi i tij janë prezentë gjithashtu edhe në këtë veprim bankar.

Ky transaksion bie ndesh me financimin islam, i cili e lidh financimin me aktivitetin real, gjë e cila sjell zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik.

Asambleja tekta vlerëson përpjekjet e bankave islame për të gjetur zgjidhje për të keqen e madhe që sjell kamata, konfirmon gjithashtu edhe rëndësinë që ka zbatimi i saktë i transaksioneve të lejuara dhe distancimi prej transaksioneve të dyshimta apo formale, të cilat të çojnë drejt kamatës së ndaluar. Për këtë arsye Asambleja sugjeron:

Bankat dhe institucionet financiare duhet të tregohen të kujdesshme që t'i shmangen kamatës me të gjitha format dhe trajtat e saj, duke venë në jetë fjalën e Allahut a.x.h.: "O ju që keni besuar, kijeni frikë Allahun dhe braktiseni atë që ka mbetur nga kamata nëse jeni besimtarë."

Konfirmojmë rolin që luajnë Asambletë e Jurispodencës Islame në orientimin e rrugës së ndërmarrë nga bankat islame për të realizuar qëllimet dhe objektivat e ekonomisë islame.

Krijimi i një Këshilli të Lartë në çdo Bankë Qëndrore në vendet islame të pavaruar nga bankat tregtare, të formuar nga dijetarë jurist dhe ekspertë të financës, në mënyrë që të shërbejë si referencë për bankat islame dhe për t'u siguruar që veprimet e tyre bankare përkojnë me legjislacionin islam.

Allahu i përket suksesi, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij. Burimi:

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=166&l=AR&cid=10>

A lejohet që i zoti i kapitalit të përcaktojë një shumë të caktuar fitimi në kompanitë me mudarebe?!

Asambleja e Jurispodencës Islame Sesioni i 14-të, vendimi i pestë

Datë: 05\08\1412H – 09/02/1992

Nuk lejohet në mudarebe (bashkimi i punës me kapitalin) që i zoti i kapitalit të përcaktojë një shumë të caktuar të pasurisë si fitim, sepse kjo

bie ndesh me thelbin e mudarebesë dhe sepse në këtë mënyrë kapitali i tij kthehet në një borxh me kamatë. Arsyja e ndalesës është fakti se fitimi që mund të realizohet mund të jetë më i vogël sesa masa e fitimit që ka përcaktuar i zoti i kapitalit duke berë të mundur që ai ta marrë fitimin të gjithin. Po ashtu, mudarebeja mund të dalë me humbje dhe fitimi mund të jetë më i vogël se përqindja që i takon të zotit të kapitalit dhe kështu punëtori del i fituar padrejtësisht.

Dallimi thelbësor që bën diferencën mes mudarebesë dhe borxhit me kamatë të cilin e praktikojnë banakat me interes është se pasuria që vihet në dorë të punëtorit është amanet dhe në çdo rast ai e nuk shpagon humbjen e saj vetëm nëse e dëmton qëllimisht apo tregohet neglizhent me të. Fitimi në mudarebe ndahet me pjesë realitive (përqindje) për të cilën kanë rënë dakort i zoti i kapitalit me punëtorin. Dijetarët më të dalluar janë pajtuar se një nga kushtet e saktësisë së mudarebesë është që fitimi të jetë një pjesë jo e përcaktuar (pra jo një fitim në masë të paracaktuar por në përqindje) midis të zotit të kapitalit dhe punëtorit pa përcaktuar një sasi të caktuar fitimi për njëren palë ose tjetren. Allahu e di më së miri.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed, mbi familjen dhe shokët e tij.
<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=139&l=AR&cid=10>

Rikthimi i tokës së lënë vakëf për rrugën ku kalojnë njerëzit

Këshilli i Përhershëm i Fetvave në Arabisë Saudite

Pyetje e katërt e fetvasë nr. 16403
Pyetje: Një person e ka lënë tokën e tij vakëf për rrugën dhe anash rrugës ka ndëruar shtëpinë e tij. Pas më shumë se tridhjetë apo dyzet vjetësh nipërit e tij vijnë dhe ndërtojnë shtëpi në tokën që gjyshi i tyre ka lënë në funksion të rrugës së përbashkët. Çfarë dispozite ka një veprim i tillë?!

Përgjigje: Kush jep një tokë në funksion të një rruge ku kalojnë njerëz me nijetin e vakëfit apo duke e shprehur gojarisht qëllimin e tij, atëherë nuk i lejohet as atij dhe as fëmijëve dhe pasardhësve të tij që ta rikthejnë edhe një herë tjetër tokën.

Allahut i përket suksesi, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة البانيا
The Albanian Imam's League



www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tiranë-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË
Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Islami, feja me më shumë ndjekës në botë

Statistikat vërtetojnë se përhapja e Islamit në vitet e ardhshme do të ndodhë me një shpejtësi të madhe. Karakteristikë e kësaj shpejtësie është se ndodh në heshtje dhe qetësi. Kjo është e vërteta në të cilën hasin më së shumti ata që merren me studimin e çështjeve islame në botë. Shifrat në vazhdim paraqesin një befasi për shumicën prej nesh. Studimet statistikore kanë qartësuar se numri i myslimanëve në botë është 2.038 miliardë (dy miliardë e tridhjetetë milionë) ndërsa përqindja më e madhe është në Azi me gjithsej 1.389.5 miliardë (një miliardë e treqindetëdhjetenëntë milionë e pesëqind mijë) ndërsa në Afrikë ka 581.58 milionë myslimanë.

Shumica e myslimanëve në botën mbarë krenohen me përkatësinë islame që kanë dhe të paktë janë ata që shprehin mosbesimin e tyre ose largimin nga feja. Ky është një argument tjetër i fuqisë së mësimëve islame.

Sipas një studimi të kryer në Britani, përqindja e atyre që kanë deklaruar përkatësinë e tyre fetare ka rënë 10% dhe kjo në një periudhë pesëvjeçare, megjithëse shumica e perëndimorëve deklarohen se janë fetarë, por këtë vetëm sa për konsideratë qytetare dhe se realiteti është krejtësisht ndryshe.

CNN ka publikuar një statistikë, sipas të cilës 1/5 e amerikanëve thonë

se nuk kanë fe. Kjo ndodh edhe në shumë vende evropiane.

Vendi më i madh mysliman tani për tani është Indonezia me 218 milionë myslimanë, pastaj vjen Pakistani me 183 milionë myslimanë, Bangladeshi me 154 milionë myslimanë, kurse vendi me numrin më të madh të myslimanëve në botë është India, e cila ka gjithsej 255 milionë myslimanë. Kurse në Kinë ka 135 milionë myslimanë.

Le të shohim statistikën më të reja të myslimanëve në botë të ndarë sipas kontinenteve: Myslimanë në Azi, janë 1.389.5 miliardë. Numri i myslimanëve në Afrikë arrin në 581.58 milionë. Në vendet evropiane, numri i tyre arrin në 56.19 milionë. Myslimanët në shtetet amerikane, janë 10.11 milionë. Myslimanët në Australi, arrijnë në 0.67 milionë, megjithëqë statistika tjera flasin për numër më të madh.

Shih: www.muslimpopulation.com.

Sigurisht, pas prezantimit të këtyre shifrave, lind një pyetje: Si ka mundur Pejgamberi Muhammed, alejhi selam, të parashikojë këtë rritje të numrit të myslimanëve para 1400 viteve po të mos ishte profet? A nuk ka thënë:

“Kjo çështje (fe) do të mbërrijë atje ku ka mbërritur nata dhe dita dhe Allahu nuk ka për të lënë shtëpi fshati apo qyteti pa e futur këtë fe,

qoftë me nder të të nderuarit apo me poshtërim të të poshtëruarit: krenari me të cilën Allahu e ngrënë Islamit dhe poshtërim, me të cilin Allahu e poshtëron mohimin.” (Transmeton Ibn Hibbani)

Muhammedi, alejhi selam, e tha këtë fjalë kur myslimanët ende nuk kishin dalë jashtë gadishullit arab. Meditoni madhështinë dhe fuqinë ndikuese të fjalëve: “...me nder të të nderuarit apo me poshtërim të të poshtëruarit...”, pra, sado që të ketë pengesa dhe probleme, sado që të përpiqen ateistët ta luftojnë këtë fe, përfundimisht ajo do të depërtojë në shtëpitë e tyre.

Ky hadith është shpjegim i ajetit: “Ai është që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fé, e mjafton Allahu dëshmitar.”

(El-Fer’h, 28)



(Vijon nga faqja 1...)

madh dhe mëshirëplotë.” Surja Ali Imran 31.

Ndërsa imam Buhariu thotë: “Muslimani më i mirë është ai që ringjall një sunet nga sunetet (tradita profetike) pasi është zhdukur.” Kurse sahabiu i njohur Abdullah in Abbasi ka thënë: “Cdo vit që kalon vdes një sunet dhe shfaqet një risi (bidat).”

E pra sot jetojmë në një kohë kur shumë sunete dhe tradita profetike janë të panjohura dhe vendin e tyre e kanë zënë risi (bidate) nga më të ndryshmet. Duke mos u mjaftuar me këto, gjendja që po përjetojnë sot muslimanët, të cilët nuk janë të bashkuar por të përçarë, amullia në të gjitha sferat e jetës, sprovat e mëdha dhe mosmarrëveshjet e shumta, bën të krijohet një atmosferë aspak e këndshme për të kënduar dhe festuar, por duhet të përvishen mëngët ku çdo mysliman të japë kontributin e tij për të dalur nga kaosi dhe prapambetja ku kanë rënë. Rizgjimi i muslimanëve nuk arrihet me festime dhe kremtime por duke ringjallur sunetin e pastër (traditën profetike) dhe duke e ndjekur atë. Një kështjellë e fortifikuar nuk çlirohet me këngë dhe poezi por me mund dhe vendosmëri. Andaj le të qëndrojmë aty ku kanë qëndruar brezat e parë për të arritur autoritetin dhe suksesin që arritën ata.

Për këtë arsye shikojmë se imam Euzai ka thënë: “Qëndro aty ku kanë qëndruar të parët tanë sepse ata me dituri kanë qëndruar aty.”


Ndërsa imam Maliku në shpjegim të ajetit Kuranor ku Allahu thotë: “**Sot e plotësova fenë Time për ju..**” ai shprehet: “Ajo që s’ka qenë fe në atë kohë s’mund të jetë as sot fe.”

Ndërkohë Allahu i Madhëruar thotë: “**Bindjuni Allahut dhe Profetit si dhe prijësve tuaj!**” Në komentim të ajetit shumë prej dijetarëve të hershëm kanë thënë se prijësit e përmendur në ajet janë dijetarët të cilët tregojnë dhe mësojnë fenë e pastër dhe sunetin e Profetit (alejhisalatu uesselam), çka do të thotë se për të praktikuar një fe të pastër duhet të ndjekim sunetin e Profetit, alejhi selam, siç e kanë kuptuar dijetarët në tre shekujt fatlumë të cilët i ka lavdëruar vetë Pejgamberi, alejhi selam.

Sahabiu i nderuar Hudhejfe ibnul Jeman thotë: “Çdo adhurim të cilën nuk e kanë praktikuar shokët e Profetit, alejhi selam, mos e praktikoni as ju, sepse të parët s’kanë lënë për të vonshmit gjë për të thënë.”

Ndërsa Abdullah ibn Umeri ka thënë: “Çdo bidat (risi në fe) është në humbje edhe sikur njerëzit ta shikojnë atë të mirë.”

Gjithashtu dhe imam Maliku ka thënë: “Fundit i këtij umeti nuk do të rregullohet vetëm se me atë rrugë e metodë që i bëri të parët tanë të kenë sukses.”



Halifi Umer, Komandanti Islam Amr

Historianët dhe Biblioteka

Shumë njerëz thellohen në diskutimet se tyre mbi disa çështje historike, dhe duke shtrembëruar faktet mundohen t'ia adresojnë njërit apo tjetrit akuza të pabaza. Akuza që nuk mbështeten mbi asnjë bazë dhe nuk përputhen me të vërtetat dhe faktet historike e sidomos - në mos gabohemi - ka të rinj e të vjetër që mund të jenë dekoruar në degën e historisë, por i përdorin faktet historike si t'iu dojë qejfi. Vepra historike mund të shkruajë çdokush, por historianët e vërtetë nuk lënë mënjane asnjë mundësi, me qëllim për të kritikuar dhe për të korriguar ato që nuk qëndrojnë, si dhe për t'u mbështetur vetëm tek faktet e vërteta. Ka edhe historianë të atillë që mund të trillojnë, thjesht sepse ua ka ënda në atë mënyrë, por duhet ditur se trillimet nuk mund të quhen fakte historike të vërteta.

Në vijim do të gjeni sipas mendimit tonë një analizë të vërtetë mbi djegien e Bibliotekës së Aleksandrisë. Para se të analizojmë le të shtojmë pyetjen: nëse është dhe a mund të vërtetohet fakti - siç u intereson disave ta thonë - që me të vërtetë arabët e kanë djegur këtë bibliotekë, apo është edhe kjo trillim i fantazisë, i nxjerrë nga kundërshtarët e islamit? Disa nga historianët ia faturojnë djegien e bibliotekës Amr Ibn Asit. Ata shkojnë edhe më tutje duke thënë se prijësi i muslimanëve Halifi Umer e paska urdhëruar Amrin që t'i vë zjarrin. Ky transmetim i pabazë, kjo gënjeshtër djallëzore shumë herë është studiuar dhe diskutuar nga historianë oksidentalë, prej të cilëve do të ishte e mjaftueshme të përmendim Gibbon-in, Alfred Butler-in, Sedillot, Gustave Le Bon e të tjerë. Ajo që duhet ditur është se këta, as që besojnë, si dhe as që japin konstatim të prerë mbi këtë çështje. Për më tepër, nuk e pranojnë supozimin dhe dyshimin e hedhur se gjoja Amr Ibn Asi e ka djegur bibliotekën, pasi ata mendojnë që të akuzojnë dikë tjetër për djegien e saj. Historianët oksidentalë, që u përmendën më lart, pohuan haptazi se një veprim i tillë është në kundërshtim me parimet islame. Le të përmendim këtu edhe faktin se asnjë prej historianëve të atëhershëm të qytetërimit islam, si Otiha, i cili ka përshkruar qytetërimin e Egjiptit me detaje, nuk e vërteton një akuzë të tillë. Një veprë e tillë bie në kundërshtim me etikën dhe moralin islam.

Gjithashtu duhet përmendur se as në dëshmitë historike të Otihas dhe as të historianëve të tjerë të atëhershëm nuk është përmendur një akuzë e tillë. Edhe në kërkimet dhe shkrimet e historianëve të tjerë muslimanë si Jakubiu, Beladhiri, Ibn Abdul Hakemi, Taberiu, Kindiu, nuk është përmendur dhe as nuk është dhënë ndonjë shenjë, sado e vogël qoftë, që të ketë lidhje me

këtë çështje. Asnjë fakt dhe argument të tillë nuk e gjejmë edhe tek historianët e mëvonshëm si Makriziu, Ebil Haseni, Sujutiu e te qindra të tjerë.

I pari historian që mund të jetë ndikuar nga ndonjë burim i paditur, i errët dhe jashtë qarkut islam, është historiani i vonshëm Abdul Latif Bagdadiu, i cili ia adreson djegien e bibliotekës Amrit. I dyti është Ibnul Kiftiu, i treti është Ebul Farag Maltiu - emri i tij i vërtetë Gregorius. Të tre këta janë në pikëpamje kronologjike afër njëri-tjetrit; i dyti dhe i treti janë ndikuar dhe inspiruar siç duket nga i pari, i cili e ka hedhur këtë akuzë pa u mbështetur në ndonjë burim të saktë. Ai nuk ka përmendur as prej cilës histori e ka marrë dhe as ka treguar gurrën prej të cilës është ujit dhe ka shuar me të etjen. Abdul Latif Bagdadiu e ka treguar ngjarjen në veprën: "Amudi Seuari" në formë aksidentale, pa sjellë asnjë dokument vërtetues. Po të thellohemi edhe më tutje mbi Abdul Latif Bagdadiun, do të mësojmë se ai paska dëgjuar të flitet për një Bibliotekë që ndodhej në Aleksandri, shenjat e së cilës qenë shlyer prej ngjarjeve dhe episodeve të ndryshme të ndodhura gjatë qindraveçarëve, aq sa pati thënë hipotetiki dhe i pabazuar në asnjë të dhënë se personi që e rrënoi bibliotekën paskësh qenë Amri. Atëherë e tërë përgjegjësia ose pjesërisht bie mbi të sepse është i pari historian që ka trilluar një legjendë të tillë, e cila nuk gjendet në librat dhe shkrimet e historianëve të mëparshëm psh: te Ibn Abdul Hakemi, e Beladhiri, te Jakubiu, te Taberiu, te Kindiu; historianë të cilët qenë më afër qytetërimit islam dhe më të hershëm kronologjikisht se Abdul Latif Bagdadiu. Me një fjalë Abdul Latif Bagdadiu e ka ngritur hipotezën e tij jo mbi fakte të vërteta historike por mbi trillime dhe shpifje.

Duhet përmendur gjithashtu, se këtë ngjarje nuk e gjejmë as në historinë e pasardhësve, të cilët u ndikuan nga historianët e mëhershëm si: Ibnul Ethiri, Makriziu, Ebil Mehasini, Sujutiu. Për këtë arsye kjo legjendë është hedhur poshtë sepse nuk qëndron mbi baza të shëndosha të historisë botërore përgjithësisht, dhe mbi ato të historisë së Islamit në mënyrë të veçantë. Nuk do ta merrnim si të vërtetë dhe të mirëqenë një akuzë që del prej dëshirave vetjake të njërit apo tjetrit; akuza me baza të kalbëta janë shpifur dhe trilluar prej shumë gjysmë-historianësh, por historianët e vërtetë nuk e luajnë bishtin për të deformuar të vërtetën.

Ata historianë që thanë se djegia e Bibliotekës së Aleksandrisë është bërë me dorën e Amrit, gjeneralit arab të përmendur, sipas urdhrit të Halifit Umer, e mbështesin tezën e

tyre mbi faktet që vijnë e që janë të paqëndrueshme përpara kritikës historike.

1- Se (gjoja) muslimanët dëshirokan, në mënyrë të prerë, të zhdukjin çdo libër me përjashtim të Kuranit dhe të Traditës Profetike.

2- Se muslimanët ishin ata që i vunë zjarrin bibliotekave perse, kur pushtuan vendet perse, siç e përmend edhe historiani Haxhi Halife në veprën e tij "Keshfe-Dh-dhunun.

3- Se këtë legjendë - trillim a imagjinatë - nuk e ka rrëfyer vetëm Ebul Faragu, porse e kanë përmendur edhe dy historianë të tjerë: Abdul Latif Bagdadiu dhe Ibn Kiftiu.

4- Gjithashtu - siç thonë këta - djegia e librave ishte gjoja një traditë e përhapur, më të cilën ngushëllohej dhe shërohej zemra e plagosur e çdo njeriu, që i kundërshtohet mendimi. Ky mund të shfryhej vetëm me këtë mënyrë veprimi. Ata përmendin se i quajtur Abdullah Ibn Tahir pati rrënuar e shkatërruar rreth vitit 212 H. librat perse, të botuara prej mage-vet. Të njëjtën rrugë ndoqi edhe Holako Tatar rreth vitit 656 H, i cili i pati hedhur librate qytet Bagdad në lumin Tigër.


Duke i marrë një e nga një të gjitha faktet e lartpërmendura, mund të arrijmë në konkluzionin se:

1- Argumenti i parë meriton të quhet fallco nga pikëpamja logjike. Morali dhe etika islame qëndronte dhe qëndron gjithnjë mbi parimin që inkurajon dhe nxit njerëzit për të përfutur dituri dhe për të mbrojtur veprat e mira. Këtë gjë e vërteton edhe vetë Ebul Faragu kur thotë se "Amri ishte një gjeneral dashurues dhe admirues i diturisë, sepse ky dëgjonte më vëmendje mendimet e shfaqura dhe fjalët e folura të Johana Grammaticues dhe e admironte këtë. Pra, gjenerali i famshëm e nderonte dhe e egzaltonte dijetarin në fjalë. Këto janë

fjalë të një të krishteri. Duhet të shtojmë gjithashtu se, muslimanët pas betejës së Bedrit lironin të gjithë ata robër të cilët u mësonin dhjetë fëmijëve muslimanë shkrim e këndim, nëse nuk ishin në gjendje të paguanin vlerën e lirit. Ky veprim demonstroi dhe dëshmon se sa fort muslimanët u jepnin guxim e kurajo njerëzve për përhapjen e dijes. Kjo që përmendëm e hedh poshtë në mënyrë më kategorike akuzën e lartpërmendur ndaj Amr Ibn Asit.

2- Sa për argumentin a faktin e dytë, që thotë se muslimanët kanë djegur bibliotekat e persëve, në kohën e pushtimit, as nuk na ka rënë në sy, as nuk kemi gjetur ndonjë historian tjetër që ta ketë përmendur këtë me përjashtim të Haxhi Halifes. Por, për shkak se ky është një ndër historianët e vonshëm nga pikëpamja kronologjike, nuk do të ishte e mundur t'i marrim për bazë fjalët e tij dhe të mbështetemi tek to, për një çështje historike kaq të rëndësishme sa kjo. Gjithçka vërtetohet po t'i hedhim një sy datës, në të cilën ka ndërruar jetë historiani i lartpërmendur. Ai vdiq rreth vitit 1067 H., që i takon rreth vitit 1657 sipas kalendarit diellor. Pra, nëse me të vërtetë muslimanët do t'i kishin djegur këto biblioteka, do ta kishin përmendur këtë fakt paraardhësit e historianit Haxhi Halife. Si përfundim, edhe argumenti i dytë është farepa baza, edhe pse atë e rrëzon menjëherë kritika historike e vërtetë.

3- Sa për argumentin e tretë që thotë se nuk është vetëm Abul Faragu që e ka rrëfyer, porse janë edhe dy historianë të tjerë, Abdul Latif Bagdadiu dhe Ibn Kiftiu, që janë dy historianë muslimanë të mëdhenj. Edhe ky argument përmbysset lehtë, me ato që thamë kur folëm për Ebul Faragun sepse, që të tre këta kanë jetuar në një epokë të vetme dhe se legjenda e tyre ka humbur. Prandaj edhe argumenti i tretë bie, pasi



dhe Biblioteka e Aleksandrisë

bazat e tij janë aq të paqëndrueshme saqë s'meriton as të përmenden.

4- Përsa i përket argumentit të katërt nuk mund të vërtetohet pretendimi i tyre sepse edhe po ta marrim vërtetësinë e kësaj legjende mbi një hipotezë të vërtetë, nuk do të mundeshim nga shkaku se Abdullah Ibn Tahiri është i vonshëm dhe veprimi i tij nuk mund të merret për bazë kundër prijësit të muslimanëve - Umerit, i cili ka ndërruar jetë në vitin 23 H. Kjo nga njëra anë, nga ana tjetër, edhe po ta zëmë se Abdullah Ibn Tahiri i dogji librat perse, edhe pse kjo nuk është e vërtetë, shkaku është se ishin prej librave të magevet, adhuresve të Zjarrit. Duke u bazuar tek parimet islame, gjejmë dallimin dhe ndryshimin më të madh dhe më të qartë midis librave të krishterë dhe librave të zjarradhuresve - magevet. Feja islame urdhëron që të nderohen pasuesit e librave të krishtera apo hebrenje, pasi që të tre palët në fillim mbështeteshin mbi një qëllim e parim rrënjësor; parim i cili nuk duhej të ndërrohej kohë pas kohe, sikurse ka ndodhur shpeshherë. Do të na mjaftonte për sa thamë ajeti Kuranor:

“Thuaj! O populli i Librit, ejani të bashkohemi në një fjalë të barabartë mes nesh dhe jush, në mënyrë që të mos adhurojmë tjetër kënd veç Allahut, që të mos i shoqërojmë asgjë në adhurim dhe të mos e marrim njëri-tjetrin për zot veç Allahut. Por, nëse jua kthejnë shpinën, thuajuni atëherë: dëshmoni se ne i jemi bindur dhe nënshtruar vullnetit të Zotit.

O populli i Librit, përse grindeni për Ibrahimin kur e dini që Teurati dhe Ungjilli kanë zbritur pas tij. A nuk po kuptoni?!” {Ali Imran 64-65}

Historianët janë zgjatur shumë për ta sqaruar e argumentuar legjendën e Ebul Faragut, Gibbon, Butler dhe Sedillot, duke analizuar dhe argumentuar se Amri dhe Umeri, që të dy, mbeten të pastër. Në asnjë mënyrë nuk do të mundet askush t'u adresojë një akuzë të tillë.

Tani, nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të përmendim edhe legjendën e Ebul Faragut, dhe pastaj le të shohim se si kjo legjendë shembet nga maja e deri në fund.

Ja se me ç'gjuhë flet ai:

“Në kohë të qytetërimit islam jetonte një burrë që kishte fituar famë të madhe ndaj muslimanëve. Ky quhej Johana Grammaticus, një prift kopt nga Aleksandria. Në këtë kohë kishte fituar dinjitet dhe autoritet saqë përmendej nëpër qarqet muslimane Johana Grammaticus. Ai ishte aleksandrian dhe i përkiste besimit të krishterë të Jakubit, pastaj u kthye nga triniteti siç besojnë të krishterët. Të gjithë peshkopët e Egjiptit

u mblodhën rreth tij dhe i kërkuan që të kthehej nga besimi i tij i gabueshëm por nuk u kthye. Atëherë u munduan që ta rrëzonin nga posti. Ai ka jetuar derisa Amr Ibn Asi hyri në Aleksandri, në kohën kur pushtoi Egjiptin. Në këtë kohë vajti tek Amri, i cili e respektoi për dijet që kishte. Amri e nderoi, i dëgjoi me vëmendje fjalët e tij filozofike, më të cilat nuk ishin mësuar ende arabët. Amri e admironte dhe e nderonte, sepse Amri ishte i mençur dhe i urtë e i dëgjonte me vëmendje ata që i vinin. E mbajti pranë dhe nuk e largoi nga vetja e vet. Një ditë Johanai i thotë: Ti ia uleren thesareve të Aleksandrisë duke i vulosur të gjitha gjërat që ndodhen brenda saj. Për çdo gjë që ke mundësi të përfitosh prej dobisë së saj nuk kam kundërshtim për të. Amri i thotë: për çfarë keni nevojë? Ai i përgjigjet: për librat e diturisë që ndodhen në thesaret e mbretërisë. Amri i thotë: nuk mund të urdhëroj dhënien e tyre veçse pasi të marr leje nga Halifi Umer Ibnul Hattab. I shkroi Umerit dhe e lajmëroi për kërkesën e Johanait dhe më pas i vjen një letër nga Umeri në të cilën shkruhej: Sa për librat që pëmende, nëse në to gjenden fjalë që nuk e kundërshtojnë Librin e Zotit, atëherë do të na mjaftonte Libri i Zotit, dhe në qoftë se në to gjenden fjalë që kundërshtojnë Librin e Zotit dhe nuk janë libra të dobishëm, atëherë merri dhe zhduki. Amri filloi t'i shpërndajë nëpër banjot e Aleksandrisë duke i djegur nëpër furrat e tyre. Një mori librash kaq e tmerrshme u dogjën për një periudhë 6-mujore.”

Tani e vetmja gjë që na mbetet është të përmbledhim mendimet e kritikëve historianë dhe më së fundi të japim edhe mendimin tonë mbi këtë legjendë.

Ja se çfarë mund të nxirret nga fjalët e historianëve të vërtetë: po të mendohet thellë legjenda e Ebul Faragut, del përfundimi se kjo legjendë më shumë i ngjan një përralle mitologjie dhe fantazie sesa një fakti të vërtetë historik. Kur Ebul Faragu përmend se librat e bibliotekës kanë qenë të mjaftueshëm për 4000 banja, për një periudhë 6-mujore, atëherë konstatimi i tij është i paarsyeshëm. Aq më tepër, sikur Amri të kishte për qëllim të rrëronte bibliotekën - sikur kjo të ekzistonte në të vërtetë - do ta kishte bërë në një herë të vetme dhe nuk do ta kishte lënë në mëshirën e pronarëve të banjave; përndryshe, do të kishte mundur Johanai, mbi të cilin Ebul Faragu e ngre legjendën e tij, të merrte librat që do t'i hynin në punë me një çmim fare të lirë. Është mëse e qartë se pa pikë dyshimi pretendimi i lartpërmendur është një përrallë.

Duhet cekur se Butler përmend që Johanai ka vdekur para se të pushtohet Aleksandria prej arabëve, 30 a 40 vjet

më parë. Nëse kjo është e vërtetë, i bie që njëra pjesë e kësaj legjende nuk qëndron. Kjo pjesë është ajo që i përket veçanërisht Johana Grammaticus. Legjenda e Ebul Faragut mbetet pa themel.

Edhe legjenda e Abdul Latifit, e Ibnul Kiftiut dhe e Ebul Faragut kanë dalë në dukje pas 600 vitesh, mbas kohës së ndodhjes së kësaj ngjarjeje të pabazë. Po edhe sikur të pajtohemi se argumentimi mbi të do të qëndronte mbi baza të vërteta, nuk do e kishin lënë pa e parashtruar dhe përmendur edhe dy historianë të tjerë, të famshëm, paraardhës të Abdul Latifit dhe Ebul Faragut; Otiha që vdiq në vitin 328 H dhe Johana, peshkopi i Niçes, ndërsa siç dihet, historia e tyre mbi Egjiptin konsiderohet si ndër burimet më të rëndësishme, mbi të cilat mbështetemi edhe ne sot. Aq më tepër, këtë lajm nuk e ka përmendur asnjë prej paraardhësve si Ibn Abdul Hakemi, Beladhiri, Jakubiu dhe Taberiu. Nuk u përmend, derisa erdhi Abdul Latifi, Ibn Kiftiu dhe Abul Faragi në shekullin e 7 të Hixhrit, që i takon shekullit të 13-të të kalendarit tonë. Sikur kjo të kishte qenë e vërtetë, do ta kishin cekur dhe shfaqur paraardhësit e tyre.

Një fakt tjetër për t'u përmendur është edhe se kësaj biblioteke i ka ra zjarri dy herë; herën e parë është djegur në kohën që u dogj flota e Julius Cezarit. Për këtë ndodhi flet historiani Plutark: “ndërsa armiqtë po pushtonin flotën e tij, u mundua Julius Caesari t'i kundërpërgjigjet me zjarr, derisa flakët e tij, të ardhura nga pellgu, u përhapën shumë dhe shkatërruan bibliotekën. “Këtë ndodhi e kanë përmendur një numër i madh historianësh. Sipas këtij transmetimi, biblioteka e madhe është djegur në vitin 40 P.Kr. Të dytën herë është djegur në kohën e Caesarit Theodos 391 pas Kr. Pas këtyre dy djegieve nuk dihet fare nëse biblioteka të jetë rindërtuar sërish. Por edhe Orasiusi ka mendimin dhe thënien e tij: kur pati vizituar qytetin e Aleksandrisë, në fillim të shekullit V-të pas Kr., kishte parë se raftet e bibliotekës ishin bosh dhe pa libra. Kjo thënie vërteton se biblioteka nuk gjendej para se ta pushtonin arabët Aleksandrinë. Duke u mbështetur mbi këtë fakt del në shesh qartazi se librat e kësaj biblioteke, që nga koha e Ptolemeve, nuk i kishte mbetur as shenjë e asgjë. Pra, gjurmë të saj nuk duken që nga fundi i shekullit të katërt pas Kr. d.m.th. që nga koha e perandorit Theodos. Siç dihet, se gjendja e Egjiptit para se të përhapej atje qytetërimi islam, d.m.th. që nga koha e Diokletienit ishte në dekadencë dhe e prapambetur në agrikulturë, industri, shkencë, arsim dhe letërsi. Do të ishte absurde që njerëzit të jenë kujdesur për ta rikthyer

këtë bibliotekë përsëri në gjendjen e saj të mëparshme.

Një pikë tjetër që na tërheq vërejtjen është edhe kjo, që mësimet e islamit janë kundër legjendës së Ebul Faragut si dhe të Abdul Latifit; ato priren dhe të çojnë në parimin që nuk duhet të cënosh librat fetare, të kujtdo qofshin, sepse është e mundur që prej tyre të përfitojnë muslimanët.

Gjithashtu, kur u dogj tempulli Serapeion mund të merret me mend fare lehtë që zjarri të ketë përfshirë librat e bibliotekës dhe të mos ketë mbetur asnjë shenjë nga kjo ngjarje.

Po në këtë mënyrë, rreth shekullit të 5-të, 6-të dhe 7-të pas Kr, nuk gjejmë në letra ndonjë shenjë apo citim që të përmendë djegien e kësaj biblioteke. Është e padiskutueshme se Egjipti para qytetërimit islam ishte i prapambetur në çdo drejtim. Pra, nuk do të ketë qenë e mundur që njerëzia të jetë kujdesur për ta ringjallur dhe për ta rikthyer dhe për ta rivënë në vend si në kohët e mëparshme një bibliotekë të tillë.

Edhe sikur ta zëmë se biblioteka kishte mbetur dërs mbërriti qytetërimi islam, më gjithë këtë, nuk do të kishte asnjë pengesë për transportimin e saj nga Romakët në Kostandinopojë, në kohën e armëpushimit. Sepse siç dihet Amri i lejoi në kohën e paqes të merrnin me vete sa të mundeshin. Ata kishin kohë dhe mjete transporti që mund të transportonin jo vetëm një bibliotekë por edhe një mori bibliotekash. Po në këtë mënyrë nuk mund të mendojmë se arabët do ta kenë luftuar shkencën dhe dijen pasi ne e dimë dhe historia dëshmon dhe pohon se ata i lironin robërit, kur ndonjëri prej tyre i mësonte 10 fëmijëve muslimanë shkrim e këndim.

Po ta shohim nga një pikëpamje tjetër, këtë çështje, do të hasim në një tjetër studim të pabazë, mbi të cilin nuk mund të qëndrojë e vërteta. Nuk do të mundeshim që ta merrnim legjendën e Ebul Faragut në këtë formë në të cilën del në shesh teprimi, fabrikimi i një gënjeshtre dhe koklavitja e fakteve sepse ka mundësi që ai të ketë qenë i dhënë me tepriçë pas fesë së tij. Sa për Abdul Latifi Bagdadiun edhe ky e ka përmendur këtë çështje rrëshkitazi, pa na dhënë, së paku burimin se nga është frymëzuar dhe pa e vërtetuar pohimin dhe hipotezën e tij qoftë edhe mbi një bazë të vogël.

Si përfundim, themi se teza mbi djegien e bibliotekës së Aleksandrisë nga gjenerali arab e islam Amr Ibn Asi, me urdhrin e Halifit Umer, nuk do të ishte veçse një shpifje, e sa për ata që e marrin si një fakt të vërtetë historik, do të mjaftonte t'u themi se është një fakt absurd dhe i pabazë e asgjë tjetër.

Historia e identitetit të Bosnjës

Nadim Zaazaa

Arritëm në Sarajevë një të diel dhjetori, diku rreth mesditës. Përshtypja e parë ishte ajo e një aeroporti të vogël të këndshëm dhe e një pritjeje të ankthshme nga një turmë shoferësh taksish që do t'i jepnin një pohim të shkujdesur me kokë, “mos u shqetësoni, është e mundur”, çdo pyetje që mund të bënit.

Me çantat të hedhura nxitimthi në bagazh dhe me ne të mbledhur si dele të humbura në kabinë, makina bëri për nga hoteli i caktuar, i cili gjendet në të përpjetën e pjesës qendrore të qytetit. E para lidhje e dukshme me Sarajevën ishin grafitet. Kur e pyetëm shoferin në ishin të ligjshme apo jo, ai u përgjigj, “Jo, por policia nuk e vret mendjen.” Midis shumë ngjashmërive që ne ndjemë, angazhimi i shpenguar ndaj sundimit të ligjit po na bënte të ndjeheshim në shtëpi.

Sarajeva ka një forcë tërheqëse, një karakter dhe një ritëm të sajën. Nuk është një kryeqytet modern, por pa diskutim që nuk është as skajor, pa peshë. Bashkekzistenca e xhamisë dhe katedrales, e lokalit të natës dhe muzeut, e ritmit europian dhe e buzikut oriental, nuk mund të bëhen bashkë assesi askund tjetër në botë, së paku në

mënyrën e natyrshme siç ngjet në Sarajevë. Për mua, Sarajeva është sikur imazhi i asaj se si Orienti do të reagoonte ndaj Perëndimit. Qyteti i shëmbëllen një reaksioni të vërtetë shkrirjeje dhe bashkekzistence, diçka që shumë vende të tjera pretendojnë ta bëjnë.

Përzierja e bën Sarajevën një vend unik. Qyteti është i vogël, dhe alternativat e jetës janë të kufizuara, por ai është i gjallë në mënyrën e tij.

Vizita jonë ishte përgjithësisht për të takuar ata që mund të flisnin me ne për luftën e Bosnjës nga qasje dhe këndvështrime të ndryshme. Por asnjë, edhe ata që mbanin leksione mbi të, dukej se nuk ishin të gatshëm të bisedonin për të vërtetën e asaj që ndjenin. Megjithatë, herë pas here do të arrinin të perceptonim diçka prej ndjenjave dhe opinioneve të caktuara, një akt që dikush mund ta përcaktonte lehtësisht si një rrëshqitje të pavetëdijshme të gjuhës. Ndërsa po lëviznim nga një vend në tjetrin, po vrisja mendjen se çfarë do të thoshte për luftën një boshnjak i zakonshëm, po qe se e quan veten të tillë. Qyteti ngjante mjaft i normalizuar, i qetë, por nën atë heshtje dukej të kishte plagë të mbuluara thellë.

Ne kaluam tetë ditë në Bosnjë: qëndruam në Sarajevë dhe vizituam qytetin e Mostarit. Njerëzit që njohëm e takuam ishin zemërbutë e të dashur. Ata manifestonin thjeshtësi, dashuri, tolerancë, dhe një karakter të gjallë e gazmor. Por gjithmonë e ndjeja se po lija pa njohur e takuar njerëz të tjerë. Ndërveprimet me shoferët e taksive, shitësit, punonjësit e restoranteve dhe njerëzit e thjeshtë në rrugë më bënë të ndjeja se kisha vetëm një imazh të vagëlluar të asaj që njerëzit përjetojnë vërtet në Sarajevë.

Sidoqoftë, në këto tetë ditë shijova mikpritjen e ngrohtë dhe ndjeva mirëkuptim e simpati për njerëzit që kishin vuajtur një përvojë të ngjashme me timen. Si një fëmijë i një shoqërie të shkatërruar nga lufta, dhe për gjithçka që di, unë isha një “sarajevës” si çdokush tjetër.


Një imazh ndryshe i Islamit

Midis dallimeve të shumta që ndeshëm, imazhi islam i Sarajevës ishte aq tërheqës. Duke qenë një banor i Lindjes së Mesme, për mua Islami ishte gjithmonë kultura mbizotëruese, dhe çdo aspekt tjetër sillej rreth bazave muslimane, qoftë në arkitekturë, gjuhë, art, zakone, apo madje në organizim. Por në

Bosnjë ishte saktësisht e kundërta. Ishte sikur kultura muslimane po përpiquej me elegancë të bëhej pjesë e imazhit më të gjerë të mjedisit.

Në një rrugë ju do të ndjenit praninë e Jugosllavisë komuniste, të Europës kristiane, dhe një identitet veçmas të ndryshëm musliman. Kjo e ndryshoi tërë imazhin e asaj çka mendohet të jesh një musliman brenda një bashkësie të tillë të ndryshme. Ishte një përvojë dhe një sugjerim pamor për atë lloj kontributi që Islami mund të ketë brenda një kulture më të gjerë. Me kohë, kjo ndjenjë bëri përpara, për t'u shndërruar në një provë të fortë të qenies së fesë islame e hapur, të aftësisë së saj për të bashkëjetuar me vlera të tjera kulturore dhe fetare, e madje për t'i pasuruar këto vlera të njerëzve që jetojnë në një mjedis modern kozmopolitan.

Islami në Bosnjë është më tepër një etnicitet se një “fe” në kuptimin ortodoks. Kjo mund të kuptohet duke vëzhguar praktikat e përditshme të një muslimani të zakonshëm boshnjak. Muslimanët boshnjakë e identifikojnë në përgjithësi veten si “boshnjakë”, që në terma kulturorë është tregues i një origjine etnike dhe i një rrënje historike të identitetit.



Arsyeja pas këtij lloji identifikimi nuk ka synuar diskreditimin e Islamit; ajo thjesht shpjegon kush janë muslimanët boshnjakë, si e zgjedhën dhe e ndoqën Islamin, çfarë e bën versionin e tyre aq unik.

Identiteti boshnjak i Bosnjës

Muslimanët në Bosnjë ishin fillimisht ose serbë, kroatë, apo boshnjakë krishterë, të cilët u konvertuan në Islam nën sundimin otoman në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë e këtej. Ka dy etnicitete të tjera që e pretendojnë rajonin si atdhe të tyre. Qoftë me nënkuptim, apo hapur, kjo është në kurriz të shtetërisë së boshnjakëve; në terma praktikë, të pretendimeve të muslimanëve për shtetëri. Një dikotomi midis dy trashëgimive historike në rajon përqendrohet në Mbretërinë e Kroacisë (Mbretëria e Tomisllavit, e krijuar në shekullin e nëntë) dhe në carizmin e Serbisë (carizmi i Dushanit, që e arriti kulmin në shekullin e katërmëdhjetë).

Zhvillimi i Kroacisë katolike dhe i Serbisë ortodokse u pa si një pasojë natyrore e ndasive krishtere në Europë. E drejta e pamohueshme për të dy etnicitetet që të kenë shtetet e tyre u pa si një trashëgimi e natyrshme e vlerave krishtere europiane, të transformuara tashmë në një version shekullar, të njohur si "demokracia liberale".

Por shteti boshnjak është pretenduar të jetë bllokuar nga dy "defekte": së pari, incidenti i "konvertimit" të muslimanëve dhe lidhja e tyre me diçka tjetër veç Europësë pas Rilindjes, dhe, së dyti, është papajtueshmëria e identitetit të tyre islam dhe konceptit evropian të "demokracisë liberale". Kjo qasje është fatkeqësisht ajo e adoptuara në sistemin shkollor në vetë Bosnjën. Po ashtu është e dukshme në mënyrën se si bashkësia ndërkombëtare u mor me luftën e Bosnjës, për të orkestruar fundin e saj. Më pas mund të ketë ndryshuar në formë, por në kontekst është akoma aty. Ky fakt zbulon një të vërtetë dhe mbulon një tjetër.

Qasja mbizotëruese që ne kemi parë i ilustron muslimanët si një grup të shkëputur nga origjina me zgjedhjen e një feje të "papajtueshme". Heronjtë e kësaj qasjeje e përdorin këtë si një prerogativë për të mos e njohur të drejtën e muslimanëve boshnjakë për vetëvendosje, e, që këtej, për shtetëri. Ky qëndrim është deklaruar në një mënyrë elokvente, që e përlligj mospranimin e muslimanëve me një zbulim racional dhe objektiv, larg prej ndjeshmërisë fetare të pretenduar. Ky arsyesim i "qytetëruar" mund të shihet si reflektues i

shekullarizmit evropian, por nxjerr në dukje të vërtetën e mohimit të boshnjakëve nga serbët dhe kroatët. Bashkëpunimi evropian në këtë lojë përfshin mbështetjen polemizuese, të bazuar në interesa, që Rusia dhe Gjermania i dhanë respektivisht Serbisë dhe Kroacisë.

Edhe pse Bashkimi Evropian që i vendosur në njohjen e deklaratës boshnjake të pavarësisë më 1992, ai që i lëkundur në dënimin e sulmit mbi shtetin boshnjak, e madje më ngurrues në përpjekjet e veta praktike për të ndërhyrë dhe për t'i ndaluar mizoritë.

Pranimi i shkatërrimit të mundshëm të Bosnjë-Hercegovinës është i dukshëm në propozimet e Konferencës Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë, të mbajtur më 4 tetor 1992. Propozimet përfshinin sugjerimet për një konfederatë të tre republikave të organizuara etnikisht, me një shkallë potencialisht domethënëse pavarësie, duke përfshirë çështjet e sigurisë. Një sugjerim tjetër mjaft i rrezikshëm ishte ai i një shteti musliman, me serbët të detyruar t'i qëndrojnë besnikë Republikës Federale të Jugosllavisë, dhe kroatët Kroacisë.

Këto sugjerime nënkuptonin mbështetje të tërthortë ndërkombëtare për antiosbianizmin. Në mënyrë të pashprehur pranonin gjithashtu motivet për nisjen e luftës; ky është pretendimi që mund të jetë i drejtë.

Vënia në diskutim e synimeve dhe motiveve të politikës europiane karshi luftës së Bosnjës dhe shpërbërjes së Jugosllavisë mund t'ia dobësojnë shkëlqimin çdo vlerësimi të duhur të politikave të saj kundrejt muslimanëve boshnjakë. Por e vërteta është se, sot e kësaj dite, qenia e muslimanëve brenda balancës komunale e etnike në Bosnjë është një fenomen i "pazakontë" për politikën europiane dhe e ka ndaluar planin për ta ndarë Bosnjën etnikisht.

Për të shtuar, ka dëshmi historike të ekzistencës së identitetit boshnjak para hyrjes së Islamit. Kam vizituar muze në Sarajevë që shfaqin prova historike të mbretërive të shekullit të tetë që deklarojnë një entitet boshnjak. Kam parë në të njëjtën kohë harta, dokumente dhe vula të mbretërve boshnjakë që provojnë se mohimi i Bosnjës mund të jetë për shkak të faktit se ajo u bë pak a shumë muslimane.

Muslimanët boshnjakë janë shtyrë forcërisht drejt izolimit politik dhe janë shtënë në një sistem federal nën të cilin çdo etnicitet ruan autonomi të konsiderueshme.

Megjithëkëtë, pamja e vërtetë e bashkekzistencës nuk mund të mohohet kur sillesh rreth Sarajevës. Banorët e qytetit janë më së shumti muslimanë, por është pikërisht kjo që dëshmon larminë dhe hapjen në të cilën të gjithë "sarajevasit" jetojnë së bashku.

Përqindja e martesave të përziera është relativisht e lartë. Procesi i plotë i identifikimit të çdo individit, nga pikëpamja historike apo shoqërore, i minimizon ndarjet që politikanët prej kohësh i mbajnë në lojë.

Natyra fetare e konfliktit

Muslimanët deklarorin se ata ishin sulmuar dhe diskriminuar, gjë e cila i pati shtyrë në vetëmbrojtje. Sido që të tëra palët në konflikt duhen konsideruar fajtoresh, shumë hollësi të habitshme tregojnë se prania e një bashkësie muslimane në Ballkan që trajtuar në një mënyrë shumë armiqësore.

Gjatë vizitës sonë në Mostar ishim veçanërisht të interesuar për faktin se qyteti është i ndarë njëlloj midis muslimanëve dhe kroatëve. Por fakti realisht i çuditshëm ishte debati për vijën e vërtetë ndarëse midis dy bashkësive. Ndërsa vija e njohur politikisht ishte ajo e një lumi që e priste qytetin më dysh, të tërë ata që takuam pohuan se kjo vijë është zgjedhur vetëm sepse ajo simbolizonte kufijtë midis territoreve të kontrolluara nga turqit dhe atyre të kontrolluara nga austriakët. Në fakt, vija ndarëse shkon përtej, për të dëshmuar se ndasitë e vërteta komunale nuk kishin të bënin aspak me një ndarje historike mes muslimanëve dhe kroatëve.

Ndërsa sistemi politik mbetet një rend vërtet kompleks, në të cilin Bosnja është ndarë dhe sakatuar përmes një formule të ndarjes së pushtetit, muslimanët vazhdojnë të adoptojnë një ligjërim paqësor përkundrejt mjedisëve të tyre rrethuese armiqësore. Muslimanët boshnjakë nuk duhet ta viktimizojnë sot veten. Ata duhet të vazhdojnë të jenë shembulli i gjallë i dëshirës së vërtetë për bashkekzistencë paqësore, pika e takimit midis Lindjes dhe Perëndimit.

Bosnja ia ka dalë t'i mbijetojë një luftë gërryerjeje; është toka që ka ngulmuar në përfaqimin e një shkrirjeje të përnjëmendtë të kulturave dhe feve. Ajo përfaqëson të vërtetën se Islami nuk është një religjion armiqësor, por një fe që i bën strehë bashkekzistencës paqësore! Autori është një shkruer i pavarur nga Libani

Përzgjedhi dhe përktheu:
Bujar M. Hoxha

Shkencëtarët:

Sexhdja mbron njeriun nga kanceri

Sipas një hulumtimi të bërë nga shkencëtarët, të përkulurit ndaj Zotit, rënia në sexhde që praktikohet gjatë faljes namazit, mbron njeriun nga kanceri. Sipas analizës së bërë nga Instituti Kombëtar i Teknologjisë Laserike në Kajro të Egjiptit, sexhdja mbron njeriun nga kanceri.

Sipas analizës, sexhdja ndikon shumë pozitivisht tek gratë shtatzëna duke e mbrojtur embrionin e tyre nga deformimet e mundshme. Krahas kësaj ndihmon edhe ndaj shumë sëmundjeve trupore dhe psikologjike.

Kryetari i Institutit Kombëtar i Teknologjisë Laserike njëherësh edhe profesor i biologjisë, Muhammed Zijaeddin Hamid pohon se në këtë periudhë trupi i njeriut nga çdo anë është duke u përballuar me rreze elektromagnetike, kështu që absorbon më shumë reze. Ndërsa, sipas profesorit, kjo energji e tepruar duhet larguar nga trupi.

Sipas analizës së shkencëtarit egjiptian energjia elektromagnetike e tubuar në trup largohet gjatë kryerjes së sexhdes. Kontakti i shtatë pjesëve të trupit me tokën, çliron energji nga trupi.

"Njeriu duke qëndruar në sexhde më pak ngacmohet nga valët elektromagnetike si dhe me kontaktin e ballit me tokën e liron energjinë", pohon profesor Zijaeddin.

Kjo ndikon pozitivisht në eliminimin e lodhjes dhe në sëmundjet e tjera.

Sipas profesorit Zijaeddin për të çliruar energjinë në mënyrë sa më të shëndoshë gjatë qëndrimit në sexhde duhet të kthehemi në drejtim të Qabes, sipas profesorit "Qabja është qendra e tokës dhe drejtim kah qendra e fytyrës së tokës është pozicioni më ideal për të çliruar energjinë nga trupi".

"Pesë kohët e namazit farz është e mjaftueshme për të larguar energjinë e tepërt nga trupi" - deklaroi shkencëtari egjiptian duke theksuar se tepërat e formuara gjatë gjumit largohen gjatë faljes së namazit të sabahut duke mundësuar një fillim të mbarë dhe të shëndoshë për një ditë të re.

Namazi i drekës, ikindisë dhe akshamit pakësojnë lodhjen dhe stresin ditor duke mundësuar një qetësi psikologjike për njeriun, ndërsa namazi i jacisë largon pjesën tjetër të energjisë së tepërt të marrë gjatë ditës duke mundësuar një gjumë të shëndoshë për njeriun.

Bar Restorant Piceri "Ishulli Luanëve"

Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



Adresa: Rruga nacionale
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17

Mobile: 00355 682153105

PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

